

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “TFOR INTERNATIONAL” shpk,

Në Tiranë, sot më datë 23.08.2023, unë i poshtëshënuari Luan Tonuzi, i datëlindjes 21.07.1973, banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: kartë identiteti me numër personal ,H30721007I, me cilësinë e “ortakut themelues” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“TFOR INTERNATIONAL” shpk,**

Neni 1. Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin **“TFOR INTERNATIONAL” shpk,** dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3 Selia


Shoqëria **“TFOR INTERNATIONAL” shpk** e ka selinë në adresë: “Rr. Sitki Çiço, hyrja 1, ap. 1, Njesia administrative Nr 3, Tirane” dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarisë për shoqërinë **“TFOR INTERNATIONAL” shpk** është: Ndertim i objekteve civile, rikonstruksion i tyre, import eksport i produkteve dhe sherbimeve të gjitha natyrave, sherbime arkitektonike dhe dizajni, nxjerrje ,perpunim, kultivim i produkteve ushqimore dhe industriale të gjitha natyrave brenda dhe jashtë Shqipërisë, etj.

Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.



Neni 6 **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote e cila zotërohet si më poshtë:

Luan Tonuzi, i datëlindjes 21.07.1973, banues në Tiranë identifikuar me dokument identifikimi: kartë identiteti me numër personal ,H30721007I, zotëron 100 % të kuotave të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7 **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8 **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Administrimi

Administrator i shoqërisë **“TFOR INTERNATIONAL” shpk** është:
Luan Tonuzi, i datëlindjes 21.07.1973, banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: kartë identiteti me numër personal H30721007I.
Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5 (pesë) vjeçar. Data e emërimit të tij përkon me datën e themelimit të shoqërisë që është data 23.08.2023.
Afati i emërimit të administratorit është deri me 23.08.2028.

Neni 10 Baza Ligjore


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11 Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortaku themelues të shoqërisë tregtare **“TFOR INTERNATIONAL” shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

**ORTAKU THEMELUES
Luan Tonuzi**



Tiranë, më datë 23.08.2023